

Programi i Bashkimit Evropian “Përkrahja e Shoqërisë Civile”  
për organizatat e shoqërisë civile



# VLERËSIMI I INTEGRITETIT NË POLICINË E KOSOVËS



Ky raport është mbështetur  
nga Bashkimi Evropian.

**POINTPULSE**   
WESTERN BALKANS PULSE FOR POLICE INTEGRITY AND TRUST

**VLERËSIMI I  
INTEGRITETIT NË  
POLICINË  
E KOSOVËS**

## VLERËSIMI I INTEGRITETIT NË POLICINË E KOSOVËS

### Botuesit

Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë  
Rr. Djure Jakšića 6/5, Beograd  
Tel: +381 11 3287 226  
E-mail: office@bezbednost.org  
www.bezbednost.org  
www.pointpulse.net

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë  
Rr. Sylejman Vokshi, Blloku B,  
Hyrja 2, Nr. 1, Prishtinë  
Tel: +381 38 221 420  
Email: info@qkss.org  
www.qkss.org  
www.pointpulse.net

### Autorë

Plator Avdiu dhe Skender Perteshi

### Redaktorë

Mentor Vrajolli dhe Saša Djordjević

### Përktheu në shqip nga anglishtja

Translation Centre

### Dizajni dhe faqosja

DTP Studio

### Shtypur nga

UNAGRAF

### Tirazhi

300

Beograd dhe Prishtinë, 2015

**Për raportin** – Ky raport botohet si pjesë e aktivitetit “Pulsi i Integritetit dhe Besueshmërisë në Polici në Ballkanin Perëndimor: POINTPULSE”. Ky aktivitet mbështetet nga Bashkimi Evropian përmes programit “Përkrahja e Shoqërisë Civile” në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA). Pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë vetëm të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian.

**Për rrjetin POINTPULSE** – Pesë organizata të shoqërisë civile: Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë (BCSP) dhe Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) nga Beogradi, Qendra për Studime të Sigurisë (CSS) nga Sarajeva, Instituti Alternativa (IA) nga Podgorica dhe Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) nga Prishtina, kanë krijuar rrjetin POINTPULSE me qëllim që të mbikëqyrin integritetin e policisë në Ballkanin Perëndimor. Qëllimi i rrjetit POINTPULSE është të kontribuojë në rritjen besimit në institucionet e zbatimit të ligjit në Ballkanin Perëndimor përmes luftimit të korrupsionit në polici dhe promovimit të integritetit në polici.

## TABELA E PËRMBAJTJES

---

LISTA E SHKURTESAVE.....	4
LISTA E FIGURAVE DHE RUBRIKAVE .....	5
<b>PËRMBLEDHJE.....</b>	<b>5</b>
<b>TRANSPARENCA.....</b>	<b>7</b>
TRANSPARENCA E PUNËS SË POLICISË ËSHTË E RREGULLUAR MIRË.....	7
DHËNIE E MË SHUMË INFORMATAVE PËR AKTIVITETET E POLICISË .....	8
ZYRTARËT POLICORË NUK E KANË KALUAR VERIFIKIMIN E SIGURISË.....	9
REKOMANDIME .....	9
<b>MENAXHMENTI DHE PROCESI I VENDIMMARRJES .....</b>	<b>9</b>
PAVARËSIA OPERATIVE E POLICISË NUK ËSHTË E GARANTUAR.....	9
ZYRTARËT POLICORË NË POZITA TË LARTA PROMOVOJNË INTERESAT E PARTIVE POLITIKE.....	10
QYTETARËT E PRANOJNË SE KA NDIKIM TË POLITIKËS NË PUNËN E POLICISË .....	12
REKOMANDIME .....	13
<b>MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE .....</b>	<b>13</b>
KORNIZA LIGJORE ËSHTË E SHËNDOSHË, POR KAPACITETET JANË ENDE TË DOBËTA.....	13
PENSIONIMI I PARAKOHSHËM NUK ËSHTË I RREGULLUAR MIRË .....	14
PROCESI JOTRSPARENT I GRADIMIT.....	14
PROBLEMET ME SISTEMIN E GRADIMIT.....	15
REKOMANDIME .....	15
<b>MENAXHIMI FINANCIAR .....</b>	<b>16</b>
KORNIZA INSTITUCIONALE VLERËSOHET TË JETË NË RREGULL .....	16
PROBLEMI ME PROKURIMIN “SEKRET” .....	17
“AFERAT” E PROKURIMIT PUBLIK .....	17
REKOMANDIME .....	18
<b>KONTROLLI I BRENDSHËM .....</b>	<b>19</b>
PRAKTIKË RELATIVISHT E MIRË E ORGANEVE TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM NË KUADËR TË POLICISË.....	19
PROBLEMET NË INSPEKTORATIN POLICOR.....	20
REKOMANDIME .....	21

MBIKËQYRJA E JASHTME .....	22
MBIKËQYRJE E DOBËT PARLAMENTARE NDAJ POLICISË .....	22
NUK KA RAPORT TË VEÇANTË TË AUDITIMIT PËR POLICINË .....	23
NUK KA KONTROLL TË PASURISË SË ZYRTARËVE POLICORË .....	23
REKOMANDIME .....	24



## Lista e shkurtesave

---

AKI	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
AKK	Agjencia Kundër Korrupsionit
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
Komisioni	Komisioni Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
PK	Policia e Kosovës
QKSS	Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
ZIMP	Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

## Lista e figurave dhe rubrikave

---

Figura 1	Ndikimi politik në PK
Rubrika 1	Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet Policisë së Kosovës dhe Prokurorit të Shtetit



## PËRMBLEDHJE

---

Policia e Kosovës radhitet ndër institucionet më të besueshme në vend sipas qytetarëve të Kosovës. Megjithatë, pavarësia dhe integriteti i saj kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Ka pasur disa raste kur ministri i Punëve të Brendshme, edhe pse në mënyrë të tërthortë, ka komentuar operacionet policore. Kjo veçanërisht është vërejtur gjatë protestave në vitin 2015 në Kosovë kundër Qeverisë. Kjo ka ngritur çështjen e depolitizimit të policisë dhe pretendimet se kjo e fundit është e ndikuar nga pushteti ekzekutiv.

Sa i përket komponentëve të tjerë të integritetit, Policia e Kosovës ende nuk ka një 'plan të integritetit' i cili do të shërbente si udhërrëfyes për parimet më themelore të integritetit të policisë për përmirësimin e llogaridhënies, paanshmërisë dhe ndershmërisë. Duke marrë parasysh se pjesëtarët e Policisë së Kosovës janë ndër më të vjetrit në rajon sa i përket moshës mesatare, pensionimi i parakohshëm i rreth 1,000 zyrtarëve policorë dhe rekrutimi i zyrtarëve të rinj, policorë do të paraqet sfida mjaft të madhe. Gjithashtu, ka nevojë për bashkëpunim më të mirë në mes të Policisë së Kosovës dhe Prokurorisë së Shtetit, forcimin e kapaciteteve profesionale dhe burimeve njerëzore të Inspektoratit Policor të Kosovës që i nevojiten për inspektimin dhe hetimin e policisë, si dhe të ketë mbikëqyrje më të mirë të aktiviteteve policore nga institucionet e jashtme mbikëqyrëse, veçanërisht nga Kuvendi i Kosovës.

Qëllimi i këtij raporti është të vlerësojë integritetin në kuadër të Policisë së Kosovës dhe të adresojë problemet e sfidat kryesore. Progresi dhe regresi i shënuar në lidhje me integritetin e policisë është vlerësuar përmes gjashtë seksioneve ose indikatorëve: transparencës në punën e policisë, ndikimit të interesave politike në punën operative të policisë, menaxhimit të burimeve njerëzore, menaxhimit financiar, kontrollit të brendshëm dhe mbikëqyrjes së jashtme të punës së policisë. Meqë ky hulumtim është gjithëpërfshirës, si i tillë ofron analizë cilësore për rëndësinë e parimeve të integritetit me qëllim që Policia e Kosovës të mbahet llogaridhënëse, e ndershme dhe etike.

Ky studim ka nxjerr gjashtë gjetje kryesore. (i) Në përgjithësi, Policia e Kosovës është transparente sa i përket ofrimit të informatave për mediat dhe publikun. Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun e policisë është përgjegjëse për të zhvilluar të gjitha aktivitetet që ndërlidhen me transparencën. Megjithatë, policia është larg nga të qenit e përkryer në këtë aspekt. Duhet të ketë shumë më pak burokraci kur bëhet fjalë për qasjen në statistika, të dhëna dhe informata më të hollësishme për punën e policisë. Së këndejmi, Policia e Kosovës duhet të jetë më pro-aktive për të garantuar transparencën e saj me kohë ndaj kërkesave për informata nga mediat, organizatat joqeveritare dhe palët e tjera përkatëse.

(ii) Përderisa ka supozime se policia është nën kontrollin politik të pushtetit ekzekutiv, ky sektor mbetet një prej sektorëve më të ndjeshëm. Korniza e tanishme ligjore nuk garanton pavarësinë e plotë operative të policisë nga Qeveria e Kosovës dhe nga Ministria e Punëve të Brendshme. Menaxhmenti i lartë i policisë zgjedhet politikisht nga ministri i Punëve të Brendshme dhe nga kryeministri i vendit.



Përveç kësaj, Policia e Kosovës është akuzuar se ka qenë nën presion politik gjatë protestave të opozitës në vitin 2015 kundër Qeverisë. Gjithashtu, shumica e qytetarëve të Kosovës besojnë se ndikimi politik në polici është shumë i fuqishëm.

(iii) Legjislacioni për rekrutimin dhe sistemin e gradimit konsiderohet të jetë i mirë. Megjithatë, Projektligji për Pensionimin e Parakohshëm të Zyrtarëve Policorë nuk është miratuar ende. Sfidat më të mëdha sa i përket menaxhimit të burimeve njerëzore në kuadër të policisë janë procesi i gradimit, pensionimi i parakohshëm dhe rekrutimi i zyrtarëve të rinj policorë. Policia e Kosovës konsiderohet ndër policitë më të 'vjetra' në rajon dhe për këtë arsye lind nevoja që ajo të reformohet. Policia ka gjithsej 7,634 pjesëtarë që janë në detyrë aktive. Ka nevojë që njësitë e policisë, personeli civil dhe zyrtarët policorë të gradave të ndryshme në kuadër të policisë të kenë trajnime shtesë për të përmirësuar më shumë përmbushjen e detyrave të sektorit të administratës së policisë dhe autorizimeve policore.

(iv) Gjatë tri viteve të fundit, Policia e Kosovës ka qenë nën kritika lidhur me menaxhimin e fondeve publike, veçanërisht për sistemin e prokurimit publik. Ky sektor është kritikuar në raportet e organizatave vendore dhe ndërkombëtare se nuk është transparent, llogaridhënës dhe për mosrespektim të ligjit, si dhe për mospërfillje të procedurave të prokurimit publik. PK-ja ia ka dalë që të krijojë trupat përgjegjëse për kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin e financave publike, si Njësinë e Auditimit të Brendshëm dhe Drejtorinë e Prokurimit.

(v) Dokumentet ligjore dhe të politikave që rregullojnë mekanizmat e kontrollit të brendshëm të policisë funksionojnë mirë. Megjithatë, duhet të ketë më shumë përparim në forcimin e politikës së integritetit dhe për ta përcaktuar atë më mirë. Për më tepër, Policia e Kosovës nuk ka plan të vetin të integritetit dhe duhet të ketë teste të integritetit për të vlerësuar përmbushjen e detyrave nga ana e zyrtarëve policorë. Përkundër kësaj, çdo vit policia bën vlerësimin e përmbushjes së detyrave të zyrtarëve policorë përmes një pyetësi që ka të bëjë me punën e përditshme të secilit zyrtarë policor. Inspektorati Policor i Kosovës, që është një institucion i pavarur nga policia dhe që vepron në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, nuk ka qenë në gjendje të bëjë testet e integritetit për zyrtarët policorë.

(vi) Ka nevojë të përmirësohet mbikëqyrja e jashtme e punës së policisë nga institucionet mbikëqyrëse. Mbikëqyrja parlamentare ka qenë e pamjaftueshme për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Policinë dhe aktiviteteteve të tjera të Policisë së Kosovës gjatë viteve 2014 dhe 2015. Gjatë këtyre dy viteve, komisioni përkatës parlamentar nuk ka nxjerrë asnjë raport për mbikëqyrjen e policisë. Sa i përket deklaratimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë policorë në Agjencinë Kundër Korrupsionit, kjo e fundit nuk ka mandat ligjor të verifikojë burimet financiare dhe materiale të pasurisë së deklaruar.





## TRANSPARENCA

---

*Oqtetarët dhe mediat në Kosovë e perceptojnë Policinë e Kosovës si institucion me transparencë të mjaftueshme.*

---

### Transparenca e punës së policisë është e rregulluar mirë

---

Transparenca e policisë është një prej parimeve udhëzuese të PK-së, e cila parashihet në Ligjin për Policinë, në mënyrë që t'i ofrohen informata publikut dhe të sigurohet që institucioni i policisë është i hapur për publikun.<sup>1</sup> Ky përkufizim ligjor është mjaft përgjithësues. Megjithatë, kjo është përforcuar më tej përmes dokumenteve strategjike të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në këto dokumente theksohet se çështjet operative dhe aktivitetet e policisë që janë me interes publik mbulohen nga ZIMP e PK-së, e cila synon t'i ofrojë publikut informata të plota dhe me kohë përmes mediave.<sup>2</sup> Sipas dokumenteve që përcaktojnë marrëdhënien e policisë me publikun, mediat kanë qasje në informatat e policisë sipas kërkesës ose në mënyrë pro-aktive,<sup>3</sup> që nënkupton përmes informacioneve, komunikatave për shtyp, fushatave të ndryshme, komunikimit përmes internetit dhe rrjeteve sociale, si dhe konferencave për shtyp. Sidoqoftë, ekzistojnë kufizime kur është fjala për informatat policore që kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare, rendin publik dhe reputacionit të të tjerëve,<sup>4</sup> të cilat nuk mund të jenë të qasshme për publikun. Megjithatë, policia nuk e ka specifikuar se çka përbën informacion të ndjeshëm në të cilin nuk mund të ketë qasje publiku.

### Dhënie e më shumë informatave për aktivitetet e policisë

---

Publiku mund të marrë informata nga policia lidhur me punët dhe vendimet e saj, nëse këto informata nuk e rrezikojnë interesin publik.<sup>5</sup> Komunikimi i PK-së me publikun bëhet përmes ZIMP të PK-së në nivel qendror dhe rajonal të policisë.<sup>6</sup> Roli parësor i ZIMP-së është të organizojë, menaxhojë dhe kordinojë të gjitha aktivitetet lidhur me bashkëpunimin ndërmjet policisë dhe mediave.<sup>7</sup> Kjo e fundit përgatit raporte ditore – raporte 24-orëshe – për aktivitetet e përgjithshme të policisë, mban konferenca për shtyp, ofron informata sipas kërkesave nga mediat ose palët tjera, ofron informata për fushata të ndryshme etj. Përveç kësaj, çdo vit policia publikon rregullisht raportin e saj vjetor i cili përfshin

---

1 Neni 2, Ligji për Policinë, Nr. 04/L-076.

2 Ministria e Punëve të Brendshme. *Strategjia e Komunikimit dhe Plani i Veprimit i Ministrisë së Punëve të Brendshme 2014-2016*. MPB, 2014: 4-10. <<http://goo.gl/pdxrnf>>

3 Po aty: 10-11.

4 Po aty: 11.

5 Sutaj, Visar dhe Canhasi, Artan. *Vlerësimi i sistemit të integritetit kombëtar në Kosovë*. Prishtinë: Instituti Demokratik i Kosovës dhe Transparency International Kosova. 2015: 98. <<http://goo.gl/cX9W22>>

6 ZIMP-ja është e organizuar në nivel qendror në kuadër të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës dhe ajo i ka tetë zyre rajonale në Drejtoritë Rajonale të Policisë në Prishtinë, Mitrovicën e jugut, Mitrovicën e veriut, Pejë, Gjiilan, Ferizaj, Gjakovë dhe Prizren.

7 Fokus grupi i organizuar nga QKSS-ja me zyrtarët policorë të Policisë së Kosovës më 7 tetor 2015.



aktivitetet dhe statistikat më të rëndësishme të policisë për 12 muajt paraprak. Ky raport përmban informata të përgjithshme për aktivitetet vjetore të policisë dhe kryesisht përmbledh informacionet e publikuara nga policia gjatë periudhës paraprake 12-mujore. Ky raport duhet të mbulojë në mënyrë më gjithëpërfshirëse funksionimin e brendshëm të policisë dhe vlerësimin e përmbushjes së detyrave nga policia. Kur është fjala për transparencën e policisë, një pjesë e rëndësishme është edhe publikimi i komunikatave për shtyp në faqen e internetit të policisë, në mënyrë që mediat, qytetarët dhe palët e tjera mund të informohen për punën e PK-së.

## Zyrtarët policorë nuk e kanë kaluar verifikimin e sigurisë

Një hap tjetër drejt transparencës së PK-së është verifikimi i sigurisë që AKI-ja e bën për zyrtarët policorë dhe zyrtarët e tjerë të institucioneve shtetërore të cilët kanë qasje në informacione të klasifikuara.<sup>8</sup> Një numër i madh i zyrtarëve të PK-së nuk ia kanë dal t'i kalojnë procedurat e verifikimit të sigurisë që i ka bërë AKI-ja. Për më tepër, policia nuk i ka zbatuar vendimet e AKI-së lidhur me procesin e verifikimit. Rrjedhimisht, zyrtarët e lartë policorë ende janë duke punuar në pozitat që i kanë pasur para vendimit të AKI-së për verifikimin e sigurisë, edhe pse ata kanë dështuar në procesin e verifikimit sipas Ligjit për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë.<sup>9</sup> Të gjithë zyrtarët policorë që kanë dështuar në procesin e verifikimit janë ankuar në gjykata dhe janë në pritje të vendimeve nga gjykatat. Megjithatë, procedurat e verifikimit të policisë nga AKI-ja dhe moszbatimi i vendimeve nga policia tregojnë se ka një mungesë të koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet këtyre dy institucioneve.

## Rekomandime

1. Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun e policisë duhet të jetë më e hapur për publikun. Më saktësisht, ZIMP-ja duhet të ofrojë informata më të detajuara për publikun, mediat dhe organizatat joqeveritare sipas kërkesave që i bëjnë për qasje në informata të policisë. Duke e ditur që policia ofron informata të përgjithshme dhe sipërfaqësore, PK-ja dhe ZIMP-ja e saj duhet t'u ofrojnë palëve përkatëse më shumë statistika për çështje të ndryshme.
2. Duhet të ketë më pak burokraci sa i përket ofrimit më të shpejtë dhe me kohë të informatave që kanë të bëjnë me aktivitetet e policisë.

8 Muharremi, Robert. *Verifikimi i sigurisë*. Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. 2014. <<http://goo.gl/FpTX8u>>

9 Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. *Progress in Kosovo's Vetting and Procurement in the Security Sector – Input for Country Report 2015*, 2015: 13.



## MENAXHMENTI DHE PROCESI I VENDIMMARRJES

---

*Pavarësia e plotë operative e policisë nga Qeveria dhe MPB-ja nuk është e garantuar. Ka supozime se ministri i Punëve të Brendshme dhe Qeveria ndërhyjnë politikisht në punën e policisë në terren.*

---

### Pavarësia operative e policisë nuk është e garantuar

---

Policia funksionon nën autoritetin e ministrit të Punëve të Brendshme dhe i jep llogari drejtpërdrejt ministrit lidhur me administrimin dhe menaxhimin e policisë. Megjithatë, autoriteti i ministrit "nuk përfshinë menaxhimin operativ të policisë."<sup>10</sup> Sidoqoftë, sipas Kushtetutës së Kosovës, kryeministri e emëron Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së pas rekomandimit të Qeverisë.<sup>11</sup> Drejtori i Përgjithshëm i PK-së zgjedhet pa ndonjë konkurs publik dhe sipas praktikës së emërimeve të mëhershme, ai kryesisht është zgjedhur nga radhët e zyrtarëve policorë që kanë qenë Zëvendës Drejtorë të Përgjithshëm të PK-së. Ministri i Punëve të Brendshme e krijon një komision për të përzgjedhur dhe propozuar kandidatët për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Zëvendës Drejtorëve të Përgjithshëm të policisë. Drejtori i Përgjithshëm i policisë dhe Zëvendës Drejtorët e Përgjithshëm emërohen për një mandat pesëvjeçar, me mundësi vazhdimi pas çdo pesë vjet, nga autoriteti që i ka emëruar.<sup>12</sup> Duke e marrë parasysh që ata emërohen nga ministri i Punëve të Brendshme, jo vetëm Drejtori i Përgjithshëm, por edhe zëvendësit e tij varen nga Qeveria sa i përket emërimit në këto poste. Në anën tjetër, Drejtori i Përgjithshëm i policisë ka të drejtë të emëroj Drejtorët e Departamenteve të PK-së, Drejtorët Rajonalë të Policisë, si dhe Komandantët e Stacioneve Policore.<sup>13</sup> Në këtë mënyrë, Qeveria ushtron kontrollin dhe ndikimin ekzekutiv në zgjedhjen e menaxhmentit të lartë të PK-së. Bashkë me ndikimin politik, PK-ja, gjithashtu, varet financiarisht nga Qeveria duke pasur parasysh se kjo e fundit e ndan buxhetin për policinë. Kur është fjala për buxhetin e policisë, Drejtori i Përgjithshëm i policisë e përgatit atë dhe ia përcjell ministrit për shqyrtim.<sup>14</sup>

### Zyrtarët policorë në pozita të larta promovojnë interesat e partive politike

---

Që nga viti 2008, institucionet përkatëse në Kosovë që ushtrojnë mbikëqyrjen e jashtme mbi PK-në e kanë potencuar në mënyrë aktive kritikën e tyre për politizimin e policisë përmes ndikimit të partisë politike<sup>15</sup> e cila e udhëheq Qeverinë. Sipas tyre, fakti se menaxhmenti i lartë i policisë emërohet dhe kontrollohet nga organet politike dëshmon se udhëheqësit e policisë nuk i përfaqësojnë interesat e policisë, por interesat politike, që do të thotë ato të kryeministrit dhe ministrit të Punëve të Brendsh-

---

10 Neni 5, Ligji për Policinë, Nr. 04/L-076.

11 Neni 128, Kushtetuta e Republikës së Kosovës (me amendamentet I-XXIV).

12 Neni 37, Ligji për Policinë, Nr. 04/L-076.

13 Nenet 37, 40 dhe 41, Ligji për Policinë, Nr. 04/L-076.

14 Nenet 51 dhe 21, Ligji për Policinë, Nr. 04/L-076.

15 Partia Demokratike e Kosovës (PDK), si partia më e madhe në koalicionin qeverisës, shpeshherë është kritikuar se ushtron ndikim politik në Policinë e Kosovës përmes Qeverisë.



me.<sup>16</sup> Madje, organet mbikëqyrëse të Kuvendit të Kosovës e kanë akuzuar Qeverinë për ndërhyrje në punët operative dhe në menaxhmentin e policisë gjatë operacionit policor në Mitrovicë, në korrik të vitit 2011.<sup>17</sup> Kjo kishte ndodhur kur ish-kryeministri i Kosovës kishte marrë një vendim të menjëhershëm për të shkarkuar Drejtorin e atëhershëm të Përgjithshëm të Policisë dhe kishte emëruar Zëvendësdrejtorin e Përgjithshëm të tij si ushtrues detyre i Drejtorit të Përgjithshëm të PK-së.<sup>18</sup> Në vendimin për shkarkimin e ish-drejtorit të policisë nuk jepej ndonjë arsye e veçantë për një veprim të tillë, që ishte kuptuar si akt i fuqishëm i trysisë politike mbi policinë nga ana e ekzekutivit.<sup>19</sup>

Në anën tjetër, protestat që ndodhën në Prishtinë gjatë vitit 2015 kundër disa prej vendimeve të Qeverisë së Kosovës kanë qenë sfidë e madhe për PK-në për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike. Përdorimi i forcës nga zyrtarët policorë në protesta ka bërë që opozita në Kosovës të pretendoj se policia është e politizuar dhe se operacionet e saj janë të ndikuara nga urdhrat politikë të Qeverisë.<sup>20</sup> Sidoqoftë, kjo është mohuar vazhdimisht nga policia e cila këmbëngul se është e pavarur nga MPB-ja kur është fjala për planet operative të policisë, përfshirë edhe menaxhimin e planeve operative gjatë protestave. Pasi që planet operative të policisë përgatiten nga Departamenti i Operacioneve dhe Drejtori i Përgjithshëm i PK-së, policia vlerëson se nuk ka ndërhyrje të MPB-së, organeve të tjera të Qeverisë ose të partive politike në operacionet e saj.<sup>21</sup>

Sidoqoftë, në tetor të vitit 2015, zyrtarët e policisë e ndaluan një deputet të Kuvendit të Kosovës që i përkiste njërit prej grupeve parlamentare të opozitës,<sup>22</sup> gjë që ngriti sërish debatin për çështjen e politizimit të mundshëm të PK-së. Meqë ai u arrestua nga policia pa pasur urdhër-arrest nga prokuroria,<sup>23</sup> opozita e akuzoi policinë të ketë qenë e urdhëruar politikisht nga Qeveria për ndalimin dhe arrestimin e kundërshtarëve të saj politikë.<sup>24</sup> Përveç kësaj, një deklaratë e ministrit të Punëve të Brendshme i cili – në të njëjtën ditë – dënoi hedhjen e gazit lotsjellës nga opozita në seancën e Kuvendit, kontribuoi që ky rast të shihet si trysni e jashtme në punën e policisë nga ata që kritikonin policinë për politizim.<sup>25</sup>

16 Intervistë, Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit, 24 qershor 2015.

17 Intervistë, Rexhep Selimi, Anëtar i Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, 30 shtator 2015.

18 Zyra e Kryeministrit të Kosovës. *Kryeministri shkarkon Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë*. 2011. <<http://goo.gl/oxm5Wk>>

19 Intervistë, Rexhep Selimi, Anëtar i Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, 30 shtator 2015.

20 Koha Net. *Vetëvendosje e Qeveria akuzojnë njëra tjetrën për dhunë, KMDLNU-ja të dyja*, 28 janar 2015. <<http://goo.gl/27xhWL>>

21 Intervistë, Baki Kelani, Zëdhënës i Policisë së Kosovës, 7 tetor 2015.

22 Albin Kurti, deputet i Kuvendit të Kosovës nga Lëvizja Vetëvendosje, u ndalua dhe intervistua në stacionin policor në Prishtinë dhe pastaj u lirua. Ai u arrestua nën dyshimin e hedhjes së gazit lotsjellës në seancën e Kuvendit të Kosovës me 8 tetor 2015. Për më shumë hollësi, shih video materialin në vijim: <<https://goo.gl/lkYGro>>

23 Gashi, Kreshnik. *Zyrtare: Policia Nuk Pati Urdhër Arrest për Albin Kurtin*, 14 tetor 2015. <<http://goo.gl/9ERTVK>>

24 Shih: <<http://goo.gl/rxdvje>>

25 Telegrafi. *Hyseni: Po tentohet të instalohet logjika e anarkisë*, 13 tetor 2015. <<http://goo.gl/0nJEVp>>



### **Rubrika 1: Mungesa e bashkëpunimit në mes të Policisë së Kosovës dhe Prokurorit të Shtetit**

*Një komponent e rëndësishme e këtij seksioni janë marrëdhëniet ekzistuese në mes të PK-së dhe prokurorisë. Duke ditur se prokuroria është përgjegjëse për udhëheqjen e hetimeve në veprat e ndryshme penale dhe civile, ajo akuzohet për mosbashkëpunim me policinë në rastet e krimeve të rënda, veçanërisht për luftimin e rasteve të korrupsionit të hetuara nga njësitë përkatëse të policisë.<sup>26</sup> Në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2015 thuhet se strukturat e gjyqësorit ende janë të prira për ndërhyrje politike. Madje, BE-ja bën thirrje për forcimin e bashkëpunimit në mes të policisë dhe prokurorisë në rastet e korrupsionit të nivelit të lartë përmes ekipeve të përbashkëta hetimore.<sup>27</sup> Kjo dëshmon për mungesën e koordinimit ndërmjet këtyre institucioneve, që duhet të jetë thelbësore për të pasur një gjendje më të mirë në fushën e sundimit të ligjit për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit.*

### **Qytetarët e pranojnë se ka ndikim të politikës në punën e policisë**


Duhet përmendur se qytetarët e Kosovës besojnë se ndikimi politik në policinë e Kosovës është mjaft i fuqishëm. Sipas një ankete për hulumtimin e opinionit të zhvilluar gjatë gjysmës së parë të vitit 2015 në kuadër të projektit POINTPULSE, 91 për qind e qytetarëve janë të mendimit se policia është e politizuar dhe se është nën kontrollin politik të institucioneve të Kosovës. 40 për qind e tyre mendojnë se deri diku ka ndërhyrje politike, 36 për qind e të anketuarve janë përgjigjur në mënyrë të vendosur se policia është plotësisht nën trysinë politike dhe 15 për qind e qytetarëve mendojnë se ka pak ndikim politik në polici. Vetëm 5 për qind e të anketuarve besojnë se politika nuk ka kurrfarë ndikimi në PK (figura 1).

26 Intervistë, Fidan Kalaja, Zëvendësdirjtor Ekzekutiv i Lëvizjes FOL, 5 tetor 2015.

27 European Commission. Kosovo 2015 Report. Brussels: European Commission, 2015: 12-15. <<http://goo.gl/UR5Mjp>>



**Figura 1: Ndikimi politik në PK<sup>28</sup>**



## Rekomandime

1. Qeveria, përfshirë Ministrinë e Punëve të Brendshme, nuk duhet të ndërhyjë në detyrat e brendshme të policisë, veçanërisht në menaxhimin e planeve operative. Ministri i Punëve të Brendshme dhe zyrtarët e tjerë të lartë të Qeverisë nuk duhet të komentojnë planet operative të policisë.
2. Duhet të ketë bashkëpunim më të mirë në mes të policisë dhe Prokurorit të Shtetit për të zhvilluar hetime të përbashkëta të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë.

<sup>28</sup> Avdiu, Plator dhe Perteshi, Skender. *Perceptimi i qytetarëve për integritetin në Policinë e Kosovës*. Beograd dhe Prishtinë: Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë dhe Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.



## MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

---

*Sfidat më të mëdha për burimet njerëzore janë gradimi dhe pensionimi i parakohshëm i zyrtarëve policorë.*

---

### Korniza ligjore është e shëndoshë, por kapacitetet janë ende të dobëta

---

Korniza ligjore lidhur me menaxhimin e burimeve njerëzore në PK konsiderohet relativisht e shëndoshë sa i përket çështjeve të rekrutimit ose përzgjedhjes së punonjësve dhe për sistemin e gradimit të zyrtarëve policorë të PK-së.

Departamenti i Burimeve Njerëzore i PK-së është i ngarkuar me përgjegjësinë për të gjitha aktivitetet e menaxhimit të burimeve njerëzore. Edhe pse PK-ja është shërbim policor profesional i krijuar nga bashkësia ndërkombëtare, asaj i mungojnë burimet e mjaftueshme në njësitë e ndryshme të saj. Në kuadër të njësive policore, personelit dhe zyrtarëve policorë të niveleve të ndryshme ka nevojë t'u ofrohen trajnime shtesë për të përmirësuar përbushjen e detyrave për sektorin administrativ të policisë dhe të autorizimeve policore.

### Pensionimi i parakohshëm nuk është i rregulluar mirë

---

Projektligji për Pensionim të Parakohshëm të Zyrtarëve Policorë nuk është miratuar ende, ndërsa legjislacioni i tanishëm nuk përmban ndonjë dispozitë në këtë aspekt.

PK-ja i ka 7,634 policë në detyrë aktive dhe moshë mesatare e tyre është më e larta në rajonin e Ballkanit Perëndimor.<sup>29</sup> Vlerësohet se mbi 4,000 zyrtarë policorë janë të moshës mbi 40 vjeçare, 2,091 zyrtarë policorë janë mbi 46 vjeç, ndërsa më pak se 1,000 zyrtarë policorë i përkasin grup-moshës 55 vjeçare.<sup>30</sup> Rrjedhimisht, MPB-ja në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë dhe Sindikatën e Policisë janë drejtpërdrejtë të përfshira në hartimin e Ligjit për Pensionimin e Parakohshëm të Zyrtarëve Policorë. Sipas të dhënave të policisë, projektligji do të parashikoj që moshë e pensionimit të policëve të jetë 55 vjeçare dhe se 1,000 policë do të pensionohen kur të hyj në fuqi ky ligj.<sup>31</sup> Një mijë policë që kanë moshën mesatare rreth 55 vjeçare do të pensionohen gradualisht dhe, rrjedhimisht, do të përzgjidhen dhe rekrutohen policë të rinj.<sup>32</sup>

Megjithatë, ky proces pritet të shoqërohet me disa sfida. Ekziston rreziku i nepotizmit gjatë rekrutimit të zyrtarëve të rinj policorë. Duke e ditur se Kosova ka shkallë të lartë të papunësisë dhe se një

---

29 Sutaj, Visar dhe Canhasi, Artan. *Vlerësimi i sistemit të integritetit kombëtar në Kosovë*. Prishtinë: Instituti Demokratik i Kosovës dhe Transparency International Kosova. 2015: 97. <<http://goo.gl/cX9W22>>

30 Shih: <<http://goo.gl/O7mf1D>>

31 Intervistë, Baki Kelani, Zëdhënës i Policisë së Kosovës, 7 tetor 2015.

32 Fokus grupi i organizuar nga QKSS-ja me zyrtarët policorë të Policisë së Kosovës më 7 tetor 2015.



numër i madh i njerëzve do të shprehin interesimin të aplikojnë për një vend pune në PK, ky proces duhet të zhvillohet në mënyrë të përpiktë nga policia dhe të mbikëqyret nga institucionet përkatëse mbikëqyrëse. Gjithashtu, rekrutimi i policëve të rinj duhet t'i kontribuoj përmirësimit të ndërtimit të kapaciteteve dhe profesionalizmit të burimeve njerëzore të PK-së.

Buxheti i policisë për vitin 2015 është 89,905,831 Euro, ndërsa paga mesatare mujore në PK është rreth 450 Euro.<sup>33</sup> Zyrtarët policorë, po ashtu, gëzojnë të drejtën e shtesave mbi pagën bazë për detyra të rrezikshme, për punën nën stres, për punën jashtë orarit dhe punën me ndërrime, punën gjatë festave ose ditëve tjera që janë ditë pushimi, caktimin në punë të veçanta dhe për shkathtësi të veçanta.<sup>34</sup> Megjithatë, aktualisht nuk ka ndonjë përfitim financiar lidhur me pensionimin për zyrtarët policorë.<sup>35</sup>

## Procesi jotransparent i gradimit

---

Gradimi i zyrtarëve policorë shihet si sfida e dytë më e madhe në lidhje me menaxhimin e burimeve njerëzore të PK-së. Policia beson se gradimi si proces është transparent dhe i hapur për publikun. Përkundër kësaj, ka pasur ankesa se si policia e udhëheq tërë këtë proces.<sup>36</sup> Ka pasur kritika për faktin se menaxhmenti i lartë i policisë gjatë procesit të gradimit ka bërë gradimin e policëve pa i marrë parasysh kriteret në fushën e profesionalizmit dhe të shkollimit.<sup>37</sup> Përveç kësaj, Qeveria e kaluar ishte kritikuar se kishte ushtruar kontroll politik brenda policisë lidhur me gradimin e disa zyrtarëve të lartë policorë, si dhe për përdorimin e ndikimit të saj për të penguar ngritjen në karrierë gjatë gradimit të zyrtarëve policorë të cilët nuk i mbështetnin politikat e Qeverisë'.<sup>38</sup>

## Problemet me sistemin e gradimit

---

Sistemi i gradimit në kuadër të PK-së është i rregulluar përmes procedurave të brendshme që ka kaluar nëpër disa ndryshime transformuese. Nga viti 1999 kur është themeluar PK-ja nga bashkësia ndërkombëtare deri në vitin 2008, ky proces ishte zhvilluar nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), i cili ka pasur autoritet ekzekutiv mbi policinë. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në shkurt të vitit 2008, përgjegjësitë në këtë fushë u janë bartur institucioneve vendore të policisë, të cilat tani janë përgjegjëse për sistemin e gradimit të zyrtarëve policorë. Sistemi i gradimit përfshin këto grada: polic i ri, polic, polic i lartë, rreshter, toger, kapiten, major, nënkolonel dhe kolonel.<sup>39</sup>

---

33 Sutaj, Visar dhe Canhasi, Artan. *Vlerësimi i sistemit të integritetit kombëtar në Kosovë*. Prishtinë: Instituti Demokratik i Kosovës dhe Transparency International Kosova. 2015: 96. <<http://goo.gl/cX9W22>>

34 Neni 47, Ligji për Policinë, Nr. 04/L-076.

35 Sutaj, Visar dhe Canhasi, Artan. *Vlerësimi i sistemit të integritetit kombëtar në Kosovë*. Prishtinë: Instituti Demokratik i Kosovës dhe Transparency International Kosova. 2015: 97. <<http://goo.gl/cX9W22>>

36 Intervistë, Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit, 24 qershor 2015.

37 Intervistë, Rifat Marmullaku, ish-zyrtar i lartë i Policisë së Kosovës, 3 korrik 2015.

38 Intervistë, Rexhep Selimi, Anëtar i Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, 30 shtator 2015.

39 Neni 45, Ligji për Policinë, Nr. 04/L-076.





Departamenti i Burimeve Njerëzore i policisë i vlerëson nevojat e stafit policor për gradim dhe ia paraqet kërkesën për aprovim Drejtorit të Përgjithshëm të policisë. Sipas zyrtarëve të lartë të policisë, MPB-ja nuk ka kurrfarë roli kur bëhet fjalë për sistemin e gradimit.<sup>40</sup> Procesi i gradimit në policisë është mbikëqyrur nga misionet e UNMIK-ut dhe EULEX-it, pa pjesëmarrjen e institucioneve mbikëqyrëse vendore. Megjithatë, Komisioni përkatës i Kuvendit të Kosovës i cili e mbikëqyr policinë ka dështuar që të përgatit raportin monitorues lidhur me sistemin e gradimit. Pavarësisht faktit se është krijuar një grup punues në kuadër të Komisionit të Kuvendit për mbikëqyrjen e gradimit në karrierë të policëve dhe të sistemit të gradimit, Komisioni nuk kishte arritur të përgatiste raportin për shkak se “dinamika dhe agjenda e punës” nuk ishte përfillur nga vet Komisioni.<sup>41</sup> Zyrtarët policorë që nuk arrijnë të kalojnë në procedurat e gradimit kanë të drejtën e ankesës dhe Drejtoria e Standardeve Profesionale luan rol vendimtar për të testuar integritetin e të gjithë kandidatëve që e kalojnë procesin e gradimit.<sup>42</sup>

### Rekomandime

---

1. PK-ja duhet të sigurojë një proces të drejtë dhe transparent të rekrutimit dhe përzgjedhjes së zyrtarëve të rinj policorë pasi të jenë pensionuar 1,000 zyrtarët policorë. Ky proces duhet të zhvillohet pa asnjë ndërhyrje nga faktorët e jashtëm, siç janë ndikimi politik, nepotizmi ose konflikti i interesit. Në anën tjetër, institucionet përkatëse duhet të garantojnë që policët e pensionuar të gëzojnë pensionim me dinjitet.
2. Sistemi i gradimit në kuadër të PK-së duhet të bëhet sipas meritës dhe të mbikëqyret nga Komisioni Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës si institucioni i jashtëm mbikëqyrës. Përveç kësaj, ky proces duhet të garantojë parimin e paanshmërisë, integritetit dhe ndershmërisë.

---

40 Fokus grupi i organizuar nga QKSS-ja me zyrtarët policorë të Policisë së Kosovës më 7 tetor 2015.

41 Intervistë, Rexhep Selimi, Anëtar i Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, 30 shtator 2015.

42 Intervistë, Izet Azizi, Drejtor i Drejtorisë për Standarde Profesionale, 7 tetor 2015.



## MENAXHIMI FINANCIAR

---

*Sistemi i prokurimit publik në kuadër të policisë mbetet një prej sfidave më të mëdha për sa i përket keqpërdorimit të fondeve publike dhe përfshirjes së zyrtarëve publikë në raste të korrupsionit.*

---

### Korniza institucionale vlerësohet të jetë në rregull

---

PK-ja e ka themeluar mekanizmin për menaxhimin e fondeve publike: Departamentin për Buxhet dhe Financa dhe Njësinë e Prokurimit Publik. Këto institucione janë përgjegjëse për menaxhimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e shpenzimit të fondeve publike. Në vitin 2015, buxheti i përgjithshëm i PK-së ishte 89,905,000 euro dhe pjesa më madhe e këtij buxheti u shpenzua në paga, investime kapitale dhe shërbime. Rreth 40 për qind e buxhetit për investime kapitale dhe shërbime ishte shpenzuar përmes procedurave të prokurimit publik. PK-ja është e obliguar t'i raportoj Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës për të gjitha aktivitetet financiare.<sup>43</sup>

Sfidat më të mëdha në fushën e prokurimit publik në PK janë mungesa e stafit profesional në njësinë e prokurimit dhe mungesa e personelit në përgjithësi për të mbikëqyrë zbatimin e kontratave të bëra me operatorë të ndryshëm ekonomikë privatë për investime kapitale dhe shërbime që i nevojiten PK-së.

### Problemi me prokurimin “sekret”

---

Fusha e prokurimit publik është e rregulluar me Ligjin për Prokurimin Publik, i cili është miratuar në vitin 2013. Së pari, ky ligj u kritikua shumë si nga departamentet e prokurimit ashtu edhe nga institucionet e mbikëqyrjes së jashtme, duke u bërë një prej pengesave kryesore për funksionimin e mirë të prokurimit publik.<sup>44</sup> Së dyti, e meta kryesore e këtij ligji ishte dispozita që favorizonte ofertën me çmimin më të ulët. Këto kritere zakonisht e bënin të pamundur përzgjedhjen e operatorëve më të përgjegjshëm ekonomikë.<sup>45</sup>

Për sa i përket institucioneve të sigurisë, Ligji për Prokurimin Publik ka mundësi të rris numrin e rasteve për keqpërdorime të mundshme. Në mënyrë specifike, ligji e mundëson shmangien nga procedurat e rregullta të prokurimit kur bëhet fjalë për kontrata specifike, të cilat kërkojnë masa të veçanta të sigurisë (Neni 3 i Ligjit për Prokurimin Publik), si dhe në rastet kur Qeveria e Kosovës me vendim të veçantë e klasifikon një kontratë si “sekrete”.<sup>46</sup>

---

43 Buxheti i Kosovës për vitin 2015.

44 Perteshi, Skender. *Llogaridhënie apo jo? Menaxhimi i parasë publike në Sektorin e Sigurisë në Kosovë*. Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. 2014. <<http://goo.gl/zxJCq>>

45 Po aty.

46 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Nr. 04/L-042.



Neni 3 i këtij ligji përcakton se autoritetit kontraktues nuk i kërkohet të ndjek ndonjë procedurë të veçantë të prokurimit ose të mbikëqyrë dispozitat e këtij ligji për shkallën e transparencës në kushtet kur respektimi i procedurave të tilla do të rrezikonte fshehtësinë legjitime ose interesat e sigurisë gjatë zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit lidhur me dhënien e një kontrate publike për të cilën Qeveria është pajtuar që ta përjashtojë nga fushëveprimi i këtij ligji sepse, (i) përmbushja e kontratës, sipas ligjit në fuqi në Kosovë kërkon që të përdoren masa të veçanta të sigurisë, ose (ii) Qeveria është pajtuar të klasifikojë lëndën e kontratës si sekrete. Përjashtimet sipas këtij neni lidhur me çështjet e caktuara do të lejohen në pajtim me Ligjin për Qasje në Dokumentet Publike.<sup>47</sup>

### “Aferat” e prokurimit publik

---

Sistemi i prokurimit publik në PK është i ndarë nga ai i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe shërben si departament i pavarur në kuadër të PK-së. Departamenti i Prokurimit Publik të PK-së i raporton drejtpërdrejt Drejtorit të Përgjithshëm të PK-së lidhur me çështje dhe procedura të ndryshme të prokurimit publik. Sistemi i prokurimit publik mbetet një prej sfidave më të mëdha në PK kur është fjala për keqpërdorimin e fondeve publike dhe përfshirjen e zyrtarëve publikë në rastet e korrupsionit.<sup>48</sup>

Gjatë viteve 2013-2014 zyrtarët e PK-së nga Departamenti i Prokurimit Publik u hetuan nga institucionet gjyqësore lidhur me përfshirjen e tyre në rastet e korrupsionit dhe keqpërdorimin e fondeve publike në tenderët e prokurimit publik.<sup>49</sup>

PK-ja ishte pllakosur nga të njëjtat sfida në procedurat e prokurimit publik në vitin 2015. Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) është duke hetuar tre tenderë të mëdhenj të policisë që kanë të bëjnë me blerjen e pajisjeve dhe uniformave për zyrtarët policorë, ndërtimin e poligonit të qitjes për PK-në dhe për objektin K9 për PK-në. Procedurat e prokurimit publik për këta tenderë nuk kanë qenë në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik; ekzistojnë dyshime se u janë bërë favore kompanive specifike dhe se është shmangur transparenca dhe konkurrenca e lirë gjatë procedurave të prokurimit publik. Hetimet në këto raste janë duke vazhduar.<sup>50</sup>

### Rekomandime

---

1. Menaxhmenti i policisë duhet të organizojë trajnime më specifike për stafin e vet lidhur me përpilimin e specifikimeve teknike, veçanërisht për prokurimin publik të pajisjeve specifike për nevoja të PK-së.

---

47 Neni 3, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Nr. 04/L-042.

48 Perteshi, Skender. *Llogaridhënie apo jo? Menaxhimi i parasë publike në Sektorin e Sigurisë në Kosovë*. Pri-shtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. 2014. <<http://goo.gl/zxJJCq>>

49 Shih: <<http://goo.gl/bdCNxk>>

50 Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. *Progress in Kosovo's Vetting and Procurement in the Security Sector – Input for Country Report 2015*, 2015.



2. Kuvendi i Kosovës duhet të planifikojë të rishikojë Ligjin për Prokurimin Publik për të përfshirë një dispozitë specifike që rregullon sektorin e sigurisë dhe të mbrojtjes në Kosovë, për shkak të ndjeshmërisë së sektorit të sigurisë.
3. Duhet të krijohet një plan i saktë i pagesave për të shmangur pagesat e mëdha në fund të vitit. Për të garantuar mbikëqyrjen e duhur të institucioneve të sigurisë, duhet të shmangen borxhet e mëdha të shtyra.



## KONTROLLI I BRENDSHËM

---

*Korniza ligjore që rregullon funksionimin e kontrollit të brendshëm të policisë është e rregulluar relativisht mirë. Nevojitet më shumë progres për forcimin e politikës së integritetit duke pasur parasysh se policia nuk ka një plan të integritetit.*

---

### **Praktikë relativisht e mirë e organeve të kontrollit të brendshëm në kuadër të policisë**

---

Sipas strukturës hierarkike të policisë, menaxhmenti i lartë i policisë ushtron kontroll vertikal mbi tërë organizatën, duke filluar nga Drejtori i Përgjithshëm. Kjo mund të vë në rrezik integritetin pasi që menaxhmenti i policisë emërohet politikisht dhe nuk mund të jetë gjithmonë i paanshëm në përbushjen e detyrave të veta.<sup>51</sup> Llojet e tjera të kontrollit të brendshëm në kuadër të policisë janë mekanizmat përkatës të brendshëm, siç janë Drejtoria për Standarde Profesionale, Komisioni i Brendshëm Disiplinor, Komisioni për Ankesa dhe Shpërblime, Auditimi i Brendshëm dhe Njësia e Inspektimit.

Policia i ka mekanizmat e vet të brendshëm të integritetit që shërbejnë për të vlerësuar përbushjen e detyrave nga zyrtarët policorë. Drejtoria për Standarde Profesionale është përgjegjëse për vlerësimin e integritetit të kandidatëve gjatë procesit të rekrutimit dhe gradimit. Përbushja e detyrave të zyrtarëve policorë vlerësohet në baza vjetore nga policia përmes një pyetësoi që ka të bëjë me punën e përditshme të secilit zyrtar të policisë. Ky vlerësim përfshin transparencën apo aftësitë në komunikim, aftësitë teknike, punën ekipore dhe bashkëpunimin me publikun si dhe vlerësimin e detyrave profesionale të të gjithë zyrtarëve policorë. Sipas policisë, ky vlerësim tregon integritetin e secilit zyrtar të policisë lidhur me kryerjen e detyrave policore.<sup>52</sup>

Sa i përket inspektimit, Njësia e Inspektimit të policisë në kuadër të Drejtorisë së Standardeve Profesionale ka bërë 203 inspektime të rregullta dhe 149 inspektime të jashtëzakonshme në vitin 2014. Inspektimet e jashtëzakonshme u fokusuan kryesisht në rritjen e disiplinës, si respektimi i orarit të punës dhe standardeve lidhur me uniformat, përdorimin e automjeteve të policisë, bashkëpunimin e ndërsjellë, rritjen e besimit të qytetarëve ndaj policisë, rritja e kontrollit të eprorëve ndaj vartësve të tyre etj.<sup>53</sup> Gjatë të njëjtit vit (2014), Drejtoria e Standardeve Profesionale ka pranuar 1,030 raste, prej të cilave 691 ishin paraqitur nga qytetarët dhe 339 raste ishin të brendshme. Kjo Drejtoria ka rekomanduar 227 masa disiplinore në vitin 2014 dhe ka bërë 282 hetime për të kaluarën kriminale të kandidatëve që kanë aplikuar për punë në polici, kandidatëve për pozita në stafin civil, në rastet e gradimit, në rastet e ri-punësimit etj.<sup>54</sup>

---

51 Sutaj, Visar dhe Canhasi, Artan. *Vlerësimi i sistemit të integritetit kombëtar në Kosovë*. Prishtinë: Instituti Demokratik i Kosovës dhe Transparency International Kosova. 2015: 101. <<http://goo.gl/cX9W22>>

52 Fokus grupi i organizuar nga QKSS-ja me zyrtarët policorë të Policisë së Kosovës më 7 tetor 2015.

53 Policia e Kosovës, Raporti Vjetor, 2014: 32.

54 Policia e Kosovës, Raporti Vjetor, 2014: 35-36.



## Problemet në Inspektoratin Policor

Inspektorati Policor i Kosovës është i pavarur nga policia dhe funksionon nën MPB-në. Veprimtaria e punës së IPK-së përfshin parandalimin, zbulimin, dokumentimin dhe hetimin e veprave penale të kryera nga punonjësit e policisë. Gjithashtu, ky institucion heton dhe inspekton shkeljet disiplinore të profilit të lartë të stafit të policisë. Për më tepër, IPK-ja përmes autorizimit nga kryeministri mund të zhvillojë hetime disiplinore kundër Drejtorit të Përgjithshëm të policisë nëse ai bën ndonjë shkelje disiplinore.<sup>55</sup>

IPK-ja mbikëqyr në mënyrë të rregullt punën e zyrtarëve policorë dhe përgatit raporte të inspektimit për menaxhimin e burimeve njerëzore, prokurimin publik, operacionet policore në raste të protestave etj.<sup>56</sup> Përveç kësaj, është e obliguar të pranojë ankesat nga qytetarët kundër zyrtarëve të policisë dhe të shqyrtojë e përcaktojë se cilat duhet të hetohen nga IPK-ja dhe cilat duhet t'i adresohen policisë, si dhe institucioneve të tjera. Gjatë vitit 2014, IPK-ja hetoi 304 zyrtarë policorë dhe pranoi 1,287 ankesa të qytetarëve. Gjatë të njëjtit vit, IPK-ja, po ashtu, ka bërë 20 arrestime, 64 rekomandime për pezullim dhe 13 rekomandime për transferim lidhur me PK-në.<sup>57</sup> IPK-ja ka bërë 149 inspektime ndaj policëve dhe ka intervistuar 279 zyrtarë policorë.

PK-ja është e sfiduar seriozisht për shkak të mungesës së testit të integritetit për zyrtarët policorë. Testet e integritetit janë thelbësore për të garantuar se zyrtarët policorë nuk i keqpërdorin autorizimet e tyre dhe, për më tepër, testet e integritetit për zyrtarët policorë zhvillohen në shumë vende të zhvilluara.<sup>58</sup> IPK-ja, e cila është e autorizuar të bëjë hetime dhe inspektime për shkeljet disiplinore të profilit të lartë të punonjësve të policisë, nuk e ka bërë asnjë test për integritetin e zyrtarëve të policisë për vitin 2014. IPK-ja e ka fajësuar prokurorinë se nuk i ka dhënë autorizimin për të zhvilluar testet e integritetit ndaj zyrtarëve policorë.<sup>59</sup> Duke ditur se Kodi i Etikës nuk është i mjaftueshëm, PK-ja duhet të ketë planin e vet të integritetit<sup>60</sup> i cili do të përcaktonte më mirë politikat e integritetit në kuadër të policisë.

Megjithatë, IPK-ja është kritikuar shpesh për mungesë të kapaciteteve njerëzore dhe profesionale për të kryer në mënyrë të suksesshme inspektimet dhe hetimet brenda policisë. PK-ja nuk është e kënaqur me punën e këtij institucioni dhe beson se inspektimet që i kryen IPK-ja, të njëjtat i bën edhe vet policia. Ndërkohë, ata kërkojnë një qartësim më të mirë të përgjegjësive të policisë dhe IPK-së

55 Neni 2, Ligji për Inspektoratin Policor të Kosovës, Nr. 03/L-231.

56 Intervistë, Arben Vrajolli, Shef i Departamentit të Inspektimit në Inspektoratin Policor të Kosovës, 29 korrik 2015.

57 Inspektorati i Policisë së Kosovës, Raporti Vjetor, 2014: 15.

58 Sutaj, Visar dhe Canhasi, Artan. *Vlerësimi i sistemit të integritetit kombëtar në Kosovë*. Prishtinë: Instituti Demokratik i Kosovës dhe Transparency International Kosova. 2015: 101. <<http://goo.gl/cX9W22>>

59 Kuvendi i Kosovës. Raportimi i Kryeshefit Ekzekutiv të Inspektoratit Policor të Kosovës në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, 17 prill 2015: 9.

60 Intervistë, Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit, 24 qershor 2015.



kur bëhet fjalë për inspektimet.<sup>61</sup> Gjithashtu, IPK-ja akuzohet se është nën ndikimin politik të MPB-së dhe Qeverisë pasi që Kryeshefi Ekzekutiv aktual i IPK-së ka qenë anëtar i partisë në pushtet në kohën kur ishte emëruar Kryeshef Ekzekutiv.<sup>62</sup> Ndërsa, mediat kanë raportuar se Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së ende nuk zhvilluar ndonjë takim me ministrin e Punëve të Brendshme.<sup>63</sup>

Gjatë viteve 2014 dhe 2015, disa zyrtarë policorë janë pezulluar nga puna vetëm pasi kjo ishte rekomanduar nga IPK-ja. Rasti më i njohur është ai i Drejtorit Rajonal të Policisë në Prizren i cili – me rekomandimin e IPK-së – ishte pezulluar nga detyra nën dyshimin se ka qenë i përfshirë në krimin të organizuar.<sup>64</sup> Sipas informatave që janë në dispozicion, zyrtarët policorë u pezulluan vetëm pas rekomandimeve të IPK-së, përkundër faktit se PK-ja ka të drejtë të marrë vendim për pezullimin e zyrtarëve policorë.

### Rekomandime

---

1. Policia duhet të përgatit planin e vet të integritetit si udhërrëfyes i nevojshëm për të përmirësuar profesionalizmin, integritetin, llogaridhënien dhe besimin e qytetarëve në polici.
2. Duhet të bëhen testet e integritetit nga Inspektorati Policor i Kosovës për të garantuar që zyrtarët policorë nuk i keqpërdorin autorizimet e tyre.
3. Mekanizmat e kontrollit të brendshëm në kuadër të policisë duhet të jenë të pavarur nga menaxhmenti i lartë i policisë gjatë kryerjes së detyrave të tyre lidhur me kontrollin e brendshëm ndaj zyrtarëve policorë.
4. Inspektorati Policor duhet të ngrit burimet e veta profesionale dhe njerëzore. Kryeshefi i ri Ekzekutiv duhet të jetë i paanshëm dhe duhet të kontribuojë më shumë në ndërtimin e kapaciteteve të këtij institucioni.

---

61 Fokus grupi i organizuar nga QKSS-ja me zyrtarët policorë të Policisë së Kosovës më 7 tetor 2015.

62 Intervistë, Rifat Marmullaku, ish-zyrtar i lartë i Policisë së Kosovës, 3 korrik 2015.

63 Shih: <<http://goo.gl/Px7gCV>>.

64 Shih: <<http://goo.gl/axHfza>>



## MBIKËQYRJA E JASHTME

---

*Mbikëqyrja e jashtme e policisë ende është e dobët. Mbikëqyrja parlamentare ka qenë e pamjaftueshme për të mbikëqyruar zbatimin e Ligjit për Policinë dhe aktivitetet e tjera përkatëse të policisë. Agjencia Kundër Korrupsionit nuk ka mandat ligjor për të verifikuar burimet financiare dhe materiale të pasurisë së deklaruar nga zyrtarët e lartë policorë.*

---

### Mbikëqyrje e dobët parlamentare ndaj policisë

---

Puna e komisionit fokusohet drejtpërdrejt në mbikëqyrjen e policisë lidhur me shpenzimet e saj. Në bashkëpunim të ngushtë me IPK-në, komisioni mbikëqyrë edhe çështjet që kanë të bëjnë me masat disiplinore kundër zyrtarëve të policisë.<sup>65</sup>

Komisioni parlamentar ka të drejtë të ftojë Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë, ministrin e Punëve të Brendshme, Kryeshefin Ekzekutiv të IPK-së dhe zyrtarët e tjerë të lartë të këtyre tri institucioneve për të raportuar para anëtarëve të komisionit. Ky i fundit është i kënaqur për sa i përket raportimit të këtyre tri institucioneve para deputetëve të Kuvendit. Gjatë vitit 2015, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë ka raportuar dy herë në komision për ekstremizmin e dhunshëm dhe bashkë me ministrin e Punëve të Brendshme ka raportuar për ngjarjet që kanë ndodhur në Kumanovë të Maqedonisë, në maj të vitit 2015. Po ashtu, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së është ftuar dhe ka raportuar para anëtarëve të komisionit në prill të vitit 2015 për aktivitetet e IPK-së ndaj policisë.

Megjithatë, gjatë 2014 dhe 2015, ky komision nuk ka arritur të mbikëqyrë punën e policisë. Edhe pse puna e tij është që të ushtrojë mbikëqyrje për zbatimin e Ligjit për Policinë, komisioni ende nuk ka përgatitur një raport për zbatimin e këtij ligji.<sup>66</sup> Më herët, në vitin 2012 dhe 2013, komisioni kishte përgatitur dy raporte mbikëqyrëse për zbatimin e Ligjit për IPK-në dhe për mbikëqyrjen e shpenzimeve buxhetore të institucioneve të sigurisë në Kosovë. Në vitin 2014, ky organ parlamentar nuk ka qenë në gjendje të përgatit raportin për mbikëqyrjen e procesit të gradimit në kuadër të PK-së, edhe pse për këtë ishte themeluar një grup punues i Komisionit për të adresuar këtë çështje.<sup>67</sup>

### Nuk ka raport të veçantë të auditimit për policinë

---

Auditori i Përgjithshëm është institucioni më i lartë për kontrollin ekonomik dhe financiar në Kosovë. Ky institucion, çdo vit publikon raporte vjetore të auditimit për institucionet publike, përfshirë edhe sektorin e sigurisë. Megjithatë, nuk përgatit ndonjë raport të veçantë për policinë. Në vend të kësaj, pjesët që kanë të bëjnë me policinë përfshihen në raportin e auditorit për menaxhimin financiar të

---

65 Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës, 2010.

66 Intervistë, Rexhep Selimi, Anëtar i Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, 30 shtator 2015.

67 Po aty.





MPB-së. Sipas zyrtarëve të lartë të këtij institucioni, gjatë vitit 2014 PK-ja ka adresuar të gjitha rekomandimet për kontrollin financiar që kishin të bënin me kontratat “sekrete” dhe specifikimet teknike të prokurimit publik në kuadër të sektorit të sigurisë.<sup>68</sup>

### **Nuk ka kontroll të pasurisë së zyrtarëve policorë**

---

Përveç kësaj, zyrtarët e lartë të institucioneve publike të Kosovës, përfshirë PK-në, duhet të deklarojnë pasurinë e tyre në AKK. Prej vitit 2008, zyrtarët e lartë të PK-së deklarojnë pasurinë e tyre për çdo vit. Sipas AKK-së, deri më sot kjo procedurë është respektuar si duhet dhe nuk është raportuar asnjë rast për ndonjë hetim nga ana e agjencisë ndaj zyrtarëve të lartë policorë lidhur me deklarinë e pasurisë së tyre.<sup>69</sup> Prej 3,030 zyrtarë të lartë publikë që e kanë deklaruar pasurinë e tyre në vitin 2014, ky numër po ashtu përfshin edhe zyrtarët e lartë policorë përkatës, edhe pse ata klasifikohen vetëm si zyrtarë të lartë publikë.<sup>70</sup> Edhe pse kanë bërë deklarinë e pasurisë së tyre, është e vështirë t’u besohet të dhënave që i deklarojnë kur dihet se AKK-ja nuk ka mandat ligjor për të verifikuar burimet financiare dhe materiale të deklaruara nga zyrtarët e lartë policorë dhe zyrtarët e tjerë të lartë të institucioneve publike.<sup>71</sup>

### **Rekomandime**

---

1. Komisioni përkatës i Kuvendit i cili e mbikëqyrë policinë duhet të jetë më pro-aktiv lidhur me mbikëqyrjen e PK-së. Duhet të përgatit raporte tremujore për të mbikëqyrur zbatimin e Ligjit për Policinë dhe Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës, si dhe për çështjet e tjera që kanë të bëjnë me punën e policisë.
2. Duhet të jepen më shumë sqarime shtesë dhe të ketë qartësi më të madhe lidhur me deklarinë e pasurisë nga zyrtarët e lartë policorë në mënyrë që të verifikohen burimet e tyre financiare dhe materiale të deklaruara në Agjencinë Kundër Korrupsionit.

---

68 Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. *Progress in Kosovo’s Vetting and Procurement in the Security Sector – Input for Country Report 2015*, 2015: 35-37.

69 Intervistë, Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit, 24 qershor 2015.

70 Agjencia Kundër Korrupsionit, Raporti Vjetor 2014, 2015: 20.

71 Sutaj, Visar dhe Canhasi, Artan. *Vlerësimi i sistemit të integritetit kombëtar në Kosovë*. Prishtinë: Instituti Demokratik i Kosovës dhe Transparency International Kosova. 2015: 99. <<http://goo.gl/cX9W22>>

# POINTPULSE

WESTERN BALKANS PULSE FOR POLICE INTEGRITY AND TRUST



[www.pointpulse.net](http://www.pointpulse.net)



[twitter.com/  
POINTPULSEnet](https://twitter.com/POINTPULSEnet)